



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
NJOFTIM PËR SHTYP

Datë 07.10.2022

**MBI ÇMIMIN E FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE NGA FSHU SHA PER
KLIENTET FAMILJARE PER MUAJIN TETOR**

Në mbledhjen e ditës së sotme, ERE diskutoi dhe vlerësoi kërkesën e ardhur në datën 06.10.2022 nga shoqëria FSHU sh.a., e cila i ka kërkuar ERE, vlerësimin e situatës aktuale në lidhje me zbatimin e Vendimit Nr.242, datë 23.09.2022 të Entit Rregulltor të Energjisë për aplikimin e çmimit të energjisë të klientëve familjarë për konsumin mbi 800 kWh.

Në ERE, për qëllime të shqyrtimit të kësaj kërkesë, nga ana e FSHU sh.a. është përcjellë Vendimi i Asamblesë së përgjithshme të shoqërisë së ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik KESH sha,. Nëpërmjet këtij vendimi, të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit të shoqërisë KESH sha, është vendosur për pezullimin e aplikimit të tarifave të shitjes së energjisë elektrike për FSHU sh.a. për muajin tetor 2022.

Gjendur në këto rrethana, u konstatua se ekzistojnë mundësitë e rivlerësimit të këtij çmimi përsëri nga KESH sh.a., bazuar në përmirësimin e treguesve tekniko-ekonomikë sikurse raportuar së fundmi, për muajin tetor 2022.

Në kushtet që kosto e blerjes së energjisë elektrike të FSHU sh.a. në zbatim të VKM 456/2022 vijon të jetë ajo e miratuar nga Asembleja e Përgjithshme e Aksionarit të KESH sh.a. prej 2.6 lekë/kWh, për të gjithë konsumatorët të cilët shërbehen në kushtet e shërbimit universal, ERE vlerësoi përsëri kërkesën e FSHU sh.a., për ndryshimin e vendimit Nr. 242, datë 23.09.2022, “Mbi miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike prej 42 lekë/kWh për konsumin mbi 800 kWh/muaj për klientët familjarë për periudhën 1 tetor – 31 dhjetor 2022”, duke lënë në fuqi për muajin tetor 2022, çmimin e shitjes me pakicë të energjisë elektrike për klientët familjarë, në masën 9.5 lekë, siç miratuar me anë të vendimit Nr. 74/2022 të Bordit të ERE.